

NON-COMPLIANCE WITH LANGUAGE STANDARDS IN ELECTRONIC COMMUNICATION

Farketa Dibra-Zeqiri

University "Ss. Cyril and Methodius" - Skopje, Republic of North Macedonia, farketadibra@gmail.com

Abstract: The last decade has seen a growing concern among linguists, members of academia, researchers and language teachers on the matter of preserving linguistic norms of the Albanian language and the relations they have with new tendencies flowing from language globalization and electronic communication. In the language plane, electronic communication has brought about a new language style, requiring attention and careful examination during teaching mother tongue in general. The language used in electronic texts is far from standard Albanian language. It contains orthographic errors varying in nature, as well as erroneous usage of language by youngsters who do not observe language accuracy.

Having the above said in mind, this study focuses on non-compliance of language norms in electronic communication. The importance of this study lies in the fact that it informs us on knowledge that students have on standard Albanian, focusing on orthography rules, since these are the rules that are challenged the most during electronic communication.

To achieve the aims of the study we observed four hundred emails, phone SMS, WhatsApp messages, Viber messages, social blogs such as Facebook, Twitter and LinkedIn etc., of students aged 15-23. The paper focused on this age group due to the fact that youngsters are the most active users of social networks. The study was conducted in the city of Skopje. The reason for choosing the capital lies in the fact that it offers a dynamic life and diverse linguistic communication. The population in the capital is heterogenous, with various dialects intertwined with new globalized linguistic elements, thus enabling diversity in the language plane.

Sample selection was random, 250 students were from high schools, 150 of them from general gymnasium stream, 100 from vocational streams, and 150 university students. In order for our sample to include various categories we combined university students, students of general gymnasium stream and vocational streams, having in mind that mother tongue as a school subject in vocational schools is taught in a limited class fund, due to the fact that such schools focus on professional studies, they do not pay attention to language aspects. The research procedure was planned prior to conducting the study, followed by the on-site data gathering plan, determining locations and times, population and sample determination. The data gathering procedure was conducted in a relatively short period: within a month we managed to gather the necessary feedback from students and university students with whom we had established prior communication thanks to school and university management staff. After gathering the data (emails, SMS, Whats App, Viber, Facebook, Twitter, LinkedIn messages), we started processing it. The scientific research methods used in this study were: data analysis and synthesis, induction and deduction methods, classification method, descriptive method.

Keywords: standard language, electronic communication, language culture, school, students.

MOSZBATIMI I STANDARDIT GJUHËSOR GJATË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK

Farketa Dibra-Zeqiri

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" - Shkup, RMV, farketadibra@gmail.com

Abstrakt: Një nga shqetësimet më të mëdha të gjuhëtarëve, akademikëve, studiuesve, pedagogëve dhe sociologëve në fushën e gjuhësisë, në dhjetëvjeçarin e fundit është ruajtja e standardit të shqipes dhe qëndrimi i tij ndaj trysnive të mëdha gjuhësore, që vijnë si rezultat i procesit të globalizimit dhe zhvillimit të teknologjisë digjitale. Në rrafshin gjuhësor, ndikimi i komunikimit elektronik është zgjeruar aq shumë, saqë vështirë se mund të kontrollohen e të parandalohen të gjitha devijimet gjuhësore. Ky realitet është një arsye më tepër, që na shtynë të mendojmë se duhet t'i kthejmë sytë edhe nga gjuha amtare, t'i kushtojmë më shumë vëmendje mësimi të gjuhës në shkollë, aq më tepër sot, kur anglishtja është bërë moto e globalizmit. Nëse u hedhim një sy teksteve, sms-ve, imejleve dhe shkrimeve të ndryshme që komunikojnë të rinjtë në rrjetet sociale, do të vërejmë se është krijuar një stil i ri i gjuhës, që është shumë larg standardit të shqipes. Në këto shkrime hasen gabime ortografike dhe shtrembërime të natyrës së ndryshme, të cilat përdoren nga të rinjtë, që nuk duan t'ia dinë për standardin. Të nxitur nga kjo pakujdesi, u përcaktuam që brenda këtij punimi të trajtojmë moszbatimin e standardit gjuhësor gjatë komunikimit elektronik, me theks të veçantë te nxënësit dhe studentët, meqenëse ata janë përdoruesit më aktiv të rrjeteve sociale.

Punimi ka një rëndësi më vete, sepse na informon lidhur me njohurit që kanë nxënësit dhe studentët për gjuhën standarde shqipe, duke u përqendruar në rregullat drejtshkrimore që thyhen më tepër gjatë komunikimit elektronik. Për arritjen e objektivave të këtij punimi u morën në shqyrtim katërqind imejle, sms në telefonat celularë, Whats App, Viber, në blogjet sociale, si: fejsbuk, twitter, linkedin etj., të nxënësve dhe studentëve nga moshë 15-23 vjeç. Hulumtimi u realizua në qytetin e Shkupit, arsyet pse zgjodhëm kryeqytetin kanë të bëjnë me faktin, se Shkupi është një kryeqendër me jetë dinamike dhe komunikim gjuhësor të lloj-llojshëm. Në të jeton një popullsi e përzier, shkak që ndikon deri te një laramani edhe në planin e shprehjes gjuhësore. Përzgjedhja e mostrës ishte e rastësishme, 250 nxënës ishin nga shkollat e mesme, prej tyre 150 nga drejtimitet e gjimnazit, 100 nga shkollat profesionale, ndërsa 150 ishin studentë. Kombinim studentë, nxënës të drejtimit të gjimnazeve të përgjithshme dhe shkollave profesionale nuk ishte i rastësishëm. Ideja e një kombinimi të tillë do të na ndihmojë, që të arrijmë rezultate më të sakta dhe të rrisim besueshmërinë e këtij hulumtimi.

Para se të fillojmë hulumtimin u hartua plani i realizimit të hulumtimit, vendi dhe koha ku do të realizohet, u përcaktua popullata dhe kampioni. Brenda një muaji, arritëm të mbledhim informacionin që na dërgonin nxënësit dhe studentet me të cilët kishim krijuar kontaktet e mëparshme, fal ndihmës së stafit drejtues të shkollave dhe universiteteve. Pas mbledhjes së informacionit (imejle-ve, sms-ve në telefonat celularë, Whats App, Viber, fejsbuk, twitter, linkedin), iu nënshtruam përpunimit të tyre. Si metodat shkencore-kërkimore që përdorëm gjatë këtij hulumtimi ishin: analiza e sinteza, metoda e induksionit dhe deduksionit, metoda e klasifikimit dhe metoda përshkruese.

Fjalët çelës: gjuhë standarde, komunikim elektronik, kulturë gjuhësore, shkollë, nxënës.

1. HYRJJE

Epoka e digjitalizimit solli ndryshime të shpejta dhe të mëdha në shoqërinë tonë, na mundësoi bartjen e informacionit dhe mënyrën e komunikimit me shpejtësi të paparashikuar dhe në kohë reale, si asnjëherë më parë. Ky zhvillim i vullshëm i teknologjisë informative u manifestua në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore, duke sjellë me vete brenda një periudhe të shkurtër kohore dhe në pak sekonda, jo vetëm informacionin nga njëra anë e botës në tjetrën, por edhe kulturat dhe mendësitë e reja. Paraqitja dhe zhvillimi i rrjetit global dhe botëror të komunikimit i quajtur internet, ka krijuar dhe mundësuar një formë të re komunikimi, e cila ka rritur ndjeshëm kontaktin ndërmjet gjuhëve të ndryshme, pavarësisht largësisë së tyre. (Cristal, 2005: 83). Kësaj dukurie nuk i ka shpëtuar as gjuha shqipe, sidomos me zhvillimin e procesit të globalizimit, i cili gjithë e më shumë po bëhet rrezik për kulturat dhe gjuhët kombëtare. Mund të parashikohet se me globalizimin e botës, në dy shekujt e ardhshëm do të vdesin gjysma e gjuhëve të popujve të vegjël (Qosja, 2002: 31). Mbrojtja e gjuhëve të rrezikuara dhe gjuhëve minoritare është bërë politikë gjuhësore edhe në Bashkimin Evropian. Përparimi i teknologjisë së informacionit shihet si një mundësi e mirë që do të ndihmonte në ruajtjen e diversitetit gjuhësor (Munishi, 2015: 42). Sot, jo vetëm në Evropë, por dhe botë ndikimi i anglishtes vërehet në çdo veprimtari jetësore, e sidomos në aspektin gjuhësor. Mediat dhe interneti janë burimet kryesore që e forcojnë zgjerimin dhe përhapjen e anglishtes, duke bërë që ajo të gëzon statusin gjuhë globale, gjuhë e cila njihet në çdo vend të botës (Cristal, 2007: 45). Një rol të madh në zgjerimin e ndikimit të anglishtes në aspektin gjuhësor ka luajtur interneti dhe kompjuteri, ky ndikim vërehet në disa shkurtesa të cilat i hasim dendur gjatë komunikimit elektronik.

Në rrafshin gjuhësor, ndikimi i komunikimit elektronik vërehet në krijimin e stileve të reja të komunikimit, të cilat zakonisht nuk janë të pranishme në botën reale, por vetëm në atë virtuale (Cristal, 2001: 13). Gjuha që përdoret në tekstet e shkruara elektronike nuk u përmbahet rregullave të drejtshkrimit të shqipes. Tekstet e mesazheve të shkruara elektronike janë larg gjuhës standarde, në to hasen gabime dhe devijime ortografike të ndryshme. Të gjitha këta gabime ndikojnë negativisht në ngritjen dhe formimin të mëtejshëm gjuhësor të nxënësit, sepse kontaktin e parë me teknologjinë digjitale nxënësi e ka që në moshën parashkollore, pikërisht atëherë kur duhet të nis edukimi gjuhësor i tij, mu në këtë fazë fillon e dëmtohet aftësia e nxënësit për t'u shprehur e për të dalluar format e rregullta të fjalëve, sepse ai mësohet vetëm me atë formë të cilën e ka dëgjuar në rrjetet sociale dhe nuk arrin ta perceptojë nëse është formë e drejtë apo e gabuar. (Cristal, 2008: 145). Ky shqetësim nuk është vetëm i joni, por edhe i gjuhëtarëve, studiuesve dhe prindërve të cilët kanë ngritur alarmin se përdorimi i çdo shkurtese, simboli, iniciali apo shkarjeje gjuhësore që vinë si rezultat i komunikimi elektronik, sado i vogël të jetë ndikon në standardin e gjuhës shqipe dhe është rrezik për shkatërrimin e tij. (Çeliku, 2001: 64).

Andaj, me anë të këtij punimi, shpresojmë që sadopak të ndikojmë në përmirësimin e kësaj situatë gjuhësore te nxënësit dhe studentët, por edhe te një rreth më i gjerë përdoruesish, sepse komunikimi elektronik është i hapur për të gjithë, duke mos njohur moshë e as gjini.

2. METODOLOGJIA

Qasjet metodologjike që kemi ndjekur gjatë realizimit të këtij hulumtimi janë në shërbim të arritjes së objektivit tonë, që është përcaktimi i shkallës së moszbatimit të standardit gjuhësor gjatë komunikimit elektronik. Për arritjen e objektivave të këtij hulumtimi u morën në shqyrtim katërqind imejle, sms në telefonat celularë, Whats App, Viber, në blogjet sociale, si: fejsbuk, twitter, linkedin etj., të nxënësve dhe studentëve nga moshë 15-23 vjeç. Hulumtimi u përqendrua te kjo moshë, meqenëse të rinjtë janë përdoruesit më aktiv, ata që e kalojnë më së shumti kohën në rrjetet sociale duke komunikuar dhe shkëmbyer mesazhe. Hulumtimi u realizua në qytetin e Shkupit, arsyeja pse zgjedhëm kryeqytetin nuk është e rastësishme, por ka të bëjnë me faktin se Shkupi është një kryeqendër me jetë dinamike dhe komunikim gjuhësor të lloj-llojshëm. Në të jeton një popullsi e përzier, e ardhur nga krahina dhe qytete të ndryshme të Maqedonisë së Veriut, e cila sjellë me vete karakteristika dhe varietete të gjuhës që flet, shkak që ndikon deri te një laramani edhe në planin e shprehjes gjuhësore.

Hulumtimi u realizua me nxënës nga këto shkolla të mesme të ciklit të lartë: SHMQSH "Zef Lush Marku"; SHEQSH "Arseni Jovkov"; SHMQSH "Cvetan Dimov"; SHMMQSH "Pançe Karagjozov"; studentë nga Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi" - Shkup, Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe Universiteti "Kliment Ohridski" - Shkup, Fakulteti Pedagogjik. Përzgjedhja e mostrës ishte e rastësishme, 250 nxënës ishin nga shkollat e mesme, prej tyre 150 nga drejtimet e gjimnazit, 100 nga shkollat profesionale, ndërsa 150 ishin studentë. Me qëllim që të arrimë rezultate sa më të sakta dhe të rrisim besueshmërinë e arritjeve të këtij hulumtimi, bëmë kombinim në mes të studentëve, nxënësve të drejtimet të gjimnazeve të përgjithshme dhe shkollave profesionale. Lënda e gjuhë amtare në shkollat profesionale mësohet me një fond më të vogël orësh në krahasim me drejtimet e gjimnazeve të përgjithshme, parësore për ta është ngritja dhe arritja profesional, ndërsa formimi dhe kultura e përgjithshme gjuhësore e nxënësve përgjithësisht për fat të keq, ngelet në plan të dytë.

Para se të fillojmë hulumtimin u hartua plani i realizimit, vendi dhe koha, përcaktuam popullatën dhe kampionin. Brenda një muaji, arritëm të mbledhim informacionet që na dërgonin nxënësit dhe studentet me të cilët kishim krijuar kontakte të mëparshme fal ndihmës së stafit drejtues të shkollave dhe universiteteve. Pas mbledhjes së informacionit (imejle-ve, sms-ve në telefonat celularë, Whats App, Viber, fejsbuk, twitter, linkedin), iu nënshtruam përpunimit të tij. Si metodat shkencore-kërkimore që përdorëm për realizimin e këtij hulumtimi ishin: analiza e sinteza, metoda e induksionit dhe deduksionit, metoda e klasifikimit dhe metoda përshkruese.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të ndikojmë sadopak në vetëdijesimin e mësimdhënësve, nxënësve, studentëve dhe mbarë shoqërisë lidhur me vlerën, rëndësinë dhe kujdesin që duhet të tregojmë për gjuhën standarde shqipe, sidomos në rrethanat e sot kur ajo, njashtu si pjesa dërmuese e gjuhëve të tjera të botës është e rrezikuar nga procesi i globalizimit.

Për të pasqyruar ndikimin që ushtron komunikimit elektronik në moszbatimin e standardit të gjuhës shqipe, gjatë shqyrtimit të (imejle-ve, sms-ve në telefonat celularë, Whats App, Viber, fejsbuk, twitter, linkedin), të nxënësve dhe studentëve, detektuam shkarjet gjuhësore dhe i klasifikuam në bazë të dukurive dhe elementeve gjuhësore, se ku ky ndikim lë gjurmë më të mëdha.

2.1. Përdorimi i shkurtesave në vend të fjalës së plotë shqipe

Përdorimi i shkurtesave është një zhvillim i natyrshëm i gjuhës së komunikimit nëpërmjet pajisjeve kompjuterike, sepse komunikojnë informacionin në mënyrën më të shpejtë të mundshme, duke kursyer kohë dhe hapësirë. Si p.sh. në vend të fjalës "përsëritje" në gjuhën shqipe përdoret shkurtesa prsh; mirëdita=mrđ; natën e mirë=ntm; ditën e mirë=dtm; mirëmëngjes=mrđ; tungjatjeta=tung; faleminderit=flm; s'ka për se=sps; kalofsh mirë=klm; ncuk=jo; detyrë shtëpie=dsh; telefon=tel; lexo=lex; ç'ka me bo=qmb; nesër=nsr; kallëzo=klx; katastrof=ks; palidhje=pldh; mrekullueshëm=xix; problem=prb; shkruaj=shkr; prandaj=prnd; të dua shumë=tdsh; të lutem=lt; zemër=zmr; femër=fr; fraer=fr; privat=prv; s'ka lidhje=skldh; nejse=njs; hesht=sht; bukur=bkr; mërzi=mrz; zile telefonom/më bëj zile=crc; në rregull=nrg; do vonohem=dvn; gjithashtu=gjthsh; fakultet=fak/fax; dërgoje=drđ etj.

2.1.1. Përveç përdorimit të shkurtesave, ndeshim edhe fjali të tëra me shkurtesa dhe pa respektua normën standarde të gjuhës shqipe

Për t'iu përshtatur kontekstit të komunikimit online, bashkëbiseduesit përdorin një gjuhë ku vërehet prirja për reduktimin e formave të fjalëve, thjeshtimin e strukturave, përdorimin e fjalëve të shkurtra e të paplota, madje pjesët e fjalive të përbëra ndahen në fjali të shkurtra, pavarësisht se janë të varura nga njëra-tjetra, shmangien nga rendi i drejtë i gjymtyrëve në fjali (Çepani, A. 2020: www.portalishkollor.al). Të rinjtë si përdorues masiv të komunikimit elektronik shkurtojnë fjalë dhe togfjalësha, deri në atë pikë, sa që shpesh ndodhë t'i humbet edhe kuptimi parësor fjalës, si në shembujt e pasqyruar më poshtë:

1. Mprit nfak vij për 5min ka sh. kom. ktu. / Më prit në fakultet vij për 5 minuta, ka shumë komunikacion këtu.
2. Ma ban 1crc kur tlex. sms. / Më bëj një zile në celular, kur ta lexosh mesazhin.
3. A shkojna nscm / A të shkojmë në Qendrën Tregtare Siti Mall?
4. Cde klx / Ç'ka do të kallëzosh/tregosh?

5. Prnm se mnjef / Pranom, se më njeh!

6. Mduket me kam kan me na cu / Më duket, se në këmbë do të na çojnë.

7. Urime dtl / Urime ditëlindjen!

Nëse i referohemi shembullit të parë shohim se kemi një fjali të përbërë, ajo që e dallon nga një fjali "normale" është se zanorja **ë** mungon, nuk është e pasqyruar aty ku duhet, ndërsa bashkëtingëllozja **sh** (është përdorur si shkurtesë) për të zëvendësuar ndajfoljen **shumë**, në vend të fjalës fakultet është përdorur shkurtesa **fak**. dhe në vend të fjalës komunikacion është përdorur shkurtesa **kom**. Po e njëjta situatë vërehet edhe në shembujt e tjerë ku përveç shkurtesave dhe mungesës së zanores **ë** dhe bashkëtingëllores **ç**, vërehet edhe një moszbatim i normës standarde, sidomos te foljet (ban, shkojna, kallëzojsh, njef, kan, cu), të cilat janë përdorur në dialektin e gegërishtes.

2.2. Gabime gjatë përdorimit të shenjave të pikësimit: pikës, presjes, pikëpresjes, pikëpyetjes, pikëçuditjes, dy pikave, thonjëzave, etj.

1. Pse tu paraqit ti / Pse t'u paraqit ti?

2. A vjen sot nfak /A vjen sot në fakultet?

3. Nuk ta harroj kurr ket tmir. flm sh. / Nuk ta harroj kurrë këtë të mirë! Faleminderit shumë!

4. Provimin e kalova u kam gzu shumë kam me shku nshpi tash. Provimin e kalova, jam gëzuar shumë, do të shkoj në shtëpi tani.

5. Ne provim do hyn Arta Nora Lejla..... / Në provim do të hynë: Arta, Nora, Lejla...

Ose mund të kemi përdorimin e disa shenjave të pikësimit radhazi ose kombinim të tyre, me idenë se në këtë mënyrë bashkëbiseduesi do të arrijë t'i kompensojë mungesën e gjesteve të fytyrës ose gjuhën e trupit që janë të zakonshme gjatë një bisedë ballë për ballë. Përsëritja e tepruar e shenjave të pikësimit flet edhe për mënyrën e përjetimeve dhe ndjesive që thuhet në bisedë mes bashkëbiseduesve.

P.sh. Çka është kjo??????? Më duket e frikshme!!!!!! A më tregon ti apo.....se nuk di si të veproj????!!!

2.3. Mungesa e apostrofit edhe e zanores ë

sjam nshpi=s'jam në shtëpi; smë duhet=s'më duhet; sësht e drejt=s'është e drejtë; svij sot=s'vij sot; sham drek=s'hamë drekë; mu ka duk=m'u ka duk; sinteresohet=s'interesohet; mir tu bo=mirë t'u bë, etj.

2.4. Shkronjat kapitale nuk përdoren në vendin e duhur

Në sms-të dhe imejlet e analizuara kemi vënë re mospërdorimin e shkronjës së madhe në një fjali të re ose kur është i domosdoshëm përdorimi i tyre, siç lypset rëndom gjatë shkrimit të emrave të përveçëm, emrave të institucioneve, emrave të periudhave letrare, titujve të librave, gazetave revistave etj. Më shqetësues është fakti se mospërdorimi i shkronjave kapitale në shembujt që kemi përzgjedhur më poshtë haset dendur edhe te studentët, të cilët në një të ardhme të afërt pritet t'ua mësojnë brezave të rinj gjuhën standarde shqipe. P.sh. Fakulteti filologjik. Unë jam studentja Selma arifi, sot isha në provim te profesoresha Luana miftari. Sot ajo kthehet prej në shkup. katedra e gjuhës dhe letërsisë shqiptare. Ligjëratat e sotme ishte për periudhën e rilindjes kombëtare.

2.5. Mungesa e theksuar e zanores ë dhe bashkëtingëllores ç dhe zëvendësimi i tyre

Në disa raste përdorimi i këtyre fonemave është më se i domosdoshëm, sepse ndihmon për të mënjeluar gabimet në leximin dhe kuptimin e përmbajtjes së një teksti të shkruar. Nuk janë të pakta çiftet e fjalëve që po të zëvendësohet **ë**-ja me **e**-në apo **c**-ja me **ç**-në, marrin kuptim tjetër. Si p.sh. **çull** bëhet **cull**, **çap** bëhet **cap**, **çik** bëhet **cik** ose **në** bëhet **ne**, **nën** bëhet **nen**, **nëna** bëhet **nena**, **ndër** bëhet **nder**, **bëj** bëhet **bej** etj. (Memushaj, 2018: 123). I gjithë ky lëmsh ndodhë, sepse këto shkronja mungojnë në tastierat e kompjuterëve, laptopeve dhe celularëve dhe duhen rregulluar me programe të posaçme, andaj të rinjtë për ta rritur shpejtësinë e komunikimit e shohin si zgjidhje ta zëvendësojnë **ë**-në me **e**-në dhe **ç**-në me **c**-në. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe raste të shmangies së **ë**-së, pa vrazhdim do të pasqyrojmë shembuj ku hasen zëvendësime dhe shmangie të **ë**-së dhe **ç**-së.

1. Te thash mso se ka me na cu krejtve. / Të thash mëso, se ka me na cu krejtve.

2. Prej catyne mesimeve jane pytet. / Prej catyne (atyre) mësimeve janë pytet.

3. Nuk jam ne shpi, ti coj ma von ne snap. / Nuk jam në shtëpi, t'i çoj/dërgoj më vonë në snap.

4. Cka kerkonte ne canten tande, i tregove kujdes. apo naser. / C'ka kërkonte në cantën tënde, i tregove kujdestares apo nesër?

5. Ajo cika qe esht te IX4 thuj asaj e con porosin naser, veç mos harro coja paret. / Ajo cika që është te IX-4, thuaj asaj e con porosinë, nesër, veç mos harro coja paratë.

2.6. Përdorimi i anglicizmave

Një dukuri e cila vërehet dendur gjatë komunikimit të të rinjve, si në rrjetet sociale, ashtu edhe në komunikimin e përditshëm verbal është përdorimi i fjalëve të huaja, sidomos nga anglishtja.

Gjuha angleze e konsideruar si gjuhë ndërkombëtare, gjuhë e globalizmit dhe e teknologjisë, mund të thuhet se ka ndikuar që fjalët e saj të gjejnë përdorim të madh në jetën e përditshme të shumë popujve, duke përfshirë edhe

popullin shqiptar. Kohët e fundit shumica e anglicizmave në gjuhën shqipe kanë depërtuar lehtësisht nëpërmjet internetit dhe rrjeteve sociale. Për lehtësi studimi i kemi klasifikuar në dy kategori dhe atë:

Fjalë a shprehje përshëndetëse në gjuhën angleze: hi, hello, haj, bay, qao, bb=bye bye etj. *Shkurtesa nga anglishtja në vend të fjalës ekuivalente në gjuhën shqipe:* ok=në rregull, mirë; yeah/yes=po; thnx/thanks në vend të fjalës shqipe "faleminderit"; net=internet; fb=facebook; sms=mesazh; pc=kompjuter; wp/Whats App=ç'kemi; pls/plz /please=të lutem; najs/nice=bukur; omg/o may god=O Zoti im; bf/best friend=miku më i mirë; cu/see you= shihemi; sys/see you soon= shihemi së shpejti; cos/because=sepse; idc/idd/i dont know=nuk e di; bus=autobus; hbd/happy birthday= urime ditëlindjen etj.

2.7. Përdorimi i Logogrameve

Një tjetër dukuri që e karakterizon komunikimin elektronik është përdorimi i numrave që zëvendësojnë një e më shumë rrokje brenda fjalës të njohura si Logogramet. Ndryshe thënë, logogramet kanë të bëjnë me përdorimin e simboleve apo germave të vetmuara për të përfaqësuar fjalën apo një pjesë të saj kur emërtimi i një simboli tingëllon ngjashëm me një rrokje të fjalës, si: vër8=vërtet; 2shim=dysim; 3gim=tregim; çk3=ç'ka ka të re; ndo1=ndonjë; me1herë=menjëherë; as1=asnjë, etj. Ndër simbolet që përdoren për të zëvendësuar një ose më shumë rrokje janë &, @ dhe disa numra, shqiptimi i të cilëve përkon me ndonjë fjalë ose pjesë fjale. P.sh. 2shimi ekzistojnë & (dhe) kjo është arsyeja që më bën të jem 5imiste (pesimiste). Pse nuk më 3gove (tregove) se kaq mirë për7eni (përshtateni) njëri me tjetrin, apo kishe 2shime (dysime).

2.8. Përdorimi i Emotikonave

Shprehjet emocionuese (emoticon-et) ose ndryshe të njohura si smile-t (nga anglishtja) përfaqësojnë shprehje të fytyrës apo edhe pjesëve të tjera të trupit nëpërmjet figurave dhe simboleve të ndryshme që shprehin gjendje emocionale të ndjenjave si: lumturi, gëzim, trishtim, fikë etj. Përdorimi i këtyre figurave po merr përmasa të mëdha për vetë faktin se kryejnë më mirë funksionin komunikues, duke përçarur më mirë mesazhin dhe kursejnë kohë, pa u lodhur për ta shprehur me gojë atë që ndiejnë. Çdo pjesëmarrës në komunikim mund të shpreh kreativitetin e vet duke i kombinuar disa nga këto shenja, sepse si mjete semiotike kanë fituar një popullaritet të veçantë në diskursin elektronik.

Me këtë qasje hulumtimi arritëm të analizojmë gjendjen faktike të komunikimit gjuhësor në formën e shkruar elektronike të nxënësit dhe studentët nga ku konstatuam, se ky lloj komunikimi është rritur ndjeshëm dhe ka marrë përmasa të mëdha, por shoqërohet me një gamë shkelje e shpërfillje ndaj normës së gjuhës standarde shqipe. Ajo që bie në sy gjatë komunikimit elektronik është mungesa e theksuar e kulturës gjuhësore të nxënësve dhe studentëve. Kultura gjuhësore e një nxënësi vjen në shprehje pikërisht gjatë komunikimit, kur ai është në gjendje që të shprehë me gojë dhe me shkrim qartë mendimet, pikëpamjet e qëndrimet, me një fjalor të pasur dhe adekuat, me gjuhë të rrjedhshme, të kuptueshme në pikëpamje gramatikore, sintaksore dhe stilistikore në nivel të normës letrare dhe të normës drejtshkrimore deri në krijimtari të pavarur (Hamiti, 2018: 242).

Në shembujt që pasqyrojmë më lart u pa se gjuha që përdoret gjatë komunikimit elektronik nuk u përmbahet rregullave të standardit gjuhësor, nëse i referohemi anës gramatikore dhe fjalorit që përdorin nxënësit dhe studentët, shohim se kjo gjuhë i ngjanë më shumë gjuhës së folur, sesa asaj të shkruar. Fjalët shkruhen me shkurtesa, zhargone, me numra, shenja dhe simbole, të cilat vënë në dukje anën emocionale të personave që komunikojnë (Hamiti, 2023: 93). Gjatë komunikimit ata duhet të përgjigjen shpejtë dhe sa më shkurt dhe për këtë arsye fjalitë e tyre në të shumtën e rasteve nuk janë gramatikisht të sakta. Shpejtësia e komunikimit është shumë e rëndësishme për ta, sidomos kur shkruajnë mesazhe në celular, duhet të kursejnë karaktere dhe kohë, për ta thënë me pak fjalë atë që mendojnë. Në një situatë të tillë, ata e kanë të vështirë të mendojnë dhe analizojnë nëse janë duke shkruar sipas rregullave të gjuhës standarde, pra nëse shkrimi i tyre është formal ose jo (Cristal, 2001: 26).

Të gjendur në mes të një realiteti të tillë, natyrisht se ne nuk do t'i shpallim luftë komunikimit elektronik, që është rezultat i zhvillimit të procesit të globalizimit, sepse është një proces që ka pushtuar botën anë e mbanë dhe ne nuk mund të qëndrojmë nën hije, por duhet të përpiqemi për një përdorim të teknologjisë digjitale në kuptimin e mirë të fjalës. Pra, të bëhemi pjesë e botës së madhe globale fillimisht duke respektuar, mbrojtur dhe kultivuar gjuhën standarde shqipe dhe kulturën shqiptare. Ky respekt ndaj vetvetes do të na hapi rrugën, që gjuha shqipe dhe kultura shqiptare të zhvillohet dhe kultivohet në përmasa planetare. E thënë shkurt: të gjejmë rrugët që pajtojnë atdhetarizmin dhe teknologjinë digjitale që t'u shmangemi ndikimeve që prishin normën standarde të gjuhës sonë (Islamaj, 2008: 8).

3. REKOMANDIME

Mbi bazë të rezultateve që arritëm nga ky hulumtim kemi propozuar disa rekomandime, duke menduar se mund të jenë të dobishme në përmirësimin e kësaj çështjeje:

- ✓ Të rritet numri i orëve për lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë si në shkollat fillore ashtu edhe në arsimin parauniversitar, sepse mungon kultura e përgjithshme gjuhësore e nxënësve për t'u shprehur drejt dhe saktë sipas normës standarde.
- ✓ Mësimi i gjuhës në ciklin e ulët duhet të jetë krejt praktik, meqenëse bazat e mirëfillta gjuhësore merren që në këtë cikël, ndërsa në ciklin e lartë njohuritë duhet vetëm të thellohen dhe zgjerohen më tej.
- ✓ Të zhvillohet procesi tri shkallësh: njohuri-shkathësi-shprehi (t'i mësojmë rregullat e shqipes standarde, të jemi të shkathtë t'i gjejmë e t'i zbatojmë rregullat dhe pasi të na krijohet shprehi në mënyrë automatike të përdorim format e sakta, pa u menduar fare).
- ✓ Mësuesi duhet të punojë sistematikisht dhe në mënyrë pedagogjike për të përmirësuar dobësitë e nxënësve në drejtshkrim dhe drejtshqiptim, duke i korrigjuar me këmbëngulje dhe duke u përqendruar në ata gabime gjuhësore që vijnë si rezultat i ndikimit të komunikimit elektronik, ku më të shpeshta janë shkurtesat që përdoren në chat dhe mesenxher, pa lënë anash edhe ndikimi e fjalëve të huaja.
- ✓ Në të gjitha universitetet e vendit të futet lënda *Kulturë e gjuhës*, si lënë e domosdoshme, pavarësisht se çfarë profesioni do të zgjedhë nxënësi në jetë, komunikimin do ta realizojë me anë të gjuhës.
- ✓ Familja ka rol të rëndësishëm kultivimin e gjuhës së nxënësve. Fryma me të cilën ushqehen fëmijët nga ana e prindërve lidhur me vlerën, ruajtjen dhe kujdesin ndaj gjuhës është një element i trashëguar nga familja, andaj nxënës të ndryshëm tregojnë kulturë të ndryshme në situata të caktuara gjuhësore.

4. PËRFUNDIM

Marrë në përgjithësi, nga e gjithë kjo që u tha më sipër, mund të përfundojmë se komunikimi elektronik është njëri ndër faktorët që ndikon në moszbatimin e normës gjuhësore, meqenëse modelet e shkruara keq ndikojnë për keq te lexuesi, por nuk mund të themi se është faktor vendimtarë. Komunikimi elektronik është një indikator që tregon nivelin e ulët të zotërimit të normave të gjuhës standarde në shkollë dhe pikërisht ky fakt, duhet të shërbejë si nxitje për Ministrinë e Arsimit që të forcojë kontrollin në shkolla dhe masat për rritjen e cilësisë së mësimdhënies së gjuhës shqipe. Shqetësimi jonë qëndron në atë se, në qoftë se kjo mënyrë komunikimi bëhet e zakonshme në çfarëdo ambienti apo situatë, pra jo vetëm një komunikim i shpejtë mes miqsh dhe shokësh, atëherë duhet të shqetësohemi se sa thellë do të shkojë dhe sa ndikim do të ketë në gjuhë.

Konkluzioni ynë është se “gjuha e internetit” nuk është përgjegjëse për prishjen e gjuhës, por ajo vetëm se zbulon disa problematika që duan përgjigje adekuate dhe të shpejta nga institucionet shtetërore të arsimit e të shkencës, përfshirë këtu shkencat kompjuterike, të cilat duhet t'i kthejnë sytë edhe nga gjuha, në mënyrë që arritjet në fushën e informatikës të shfrytëzohen për të rritur shkallën e përvetësimit të gjuhës shqipe nga folësit e saj (Memushaj, 2018: 126). Natyrisht, se ne nuk mund të qëndrojmë inferior ndaj dukurisë së globalizmit, gjuhëtari Xhevat L. Loshi në librin e tij “E duam drejtshkrimin si gjithë Europa”, thekson se duhet të mësohemi të jetojmë në një botë shumëgjuhëshe, duke ruajtur identitetin tonë dhe gjuhën tonë të shtrenjtë (Loshi, 2022: 34). Që të integrohemi në këtë botë të madhe globale me të gjitha avantazhet dhe disavantazhet e saj, duhet të luftojmë që te nxënësit t'i forcojmë njohuritë elementare të natyrës së gjuhës shqipe; të kujdesemi për ruajtjen e standardit; dhe të gjejmë mundësi të ndryshme për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në shkollë fillore, aty ku brumoset dhe kalitet shkrim-leximi i nxënësit.

REFERENCAT

- Cristal, D. (2001). Language and the internet. Cambridge University Press.
- Cristal, D. (2005). The Language Revolution. Cambridge: Polity Press.
- Cristal, D. (2008). Txtng: the gr8 deb8. Oxford: Oxford University Press.
- Cristal, D. (2007). The Fight for English: How language Pundits ate, shot and left. Oxford: Oxford University Press.
- Çeliku, M. (2001). Çështje të shqipes standarde. Tiranë: Libri Universitar.
- Çepani, A. (2020). Internet: <https://www.portalishkollor.al/news/shqipja-e-perdorur-ne-rrjete-sociale-rasti-i-facebook-ut-shkarkuar-me-2023>.
- Hamiti, A. (2018). Kultura e gjuhës për të gjithë. Shkup.
- Hamiti, A. (2023). Shpërfillja e shqipes nga shqiptarët! ALBANOLOGJIA | Vol. 10 No. 19-20. Tetovë.
- Islamaj, Sh. (2008). Aspekti gjuhësor i globalizmit dhe shqipja standarde, Sesion Shkencor në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë.
- <https://www.pressreader.com/albania/gazeta-shqiptare/20140629/281878706464801>.

- Lloshi, Xh. (2022). E duam drejtshkrimin si gjithë Europa. Shkup.
Memushaj, R. (2018). Për shqipen standarde III. Tiranë: Toena.
Munishi, Sh. (2015). Shqipja në epokën e globalizimit. Prishtinë: Zeroprint.
Qosja, R. (2002). Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas, Studime filologjike nr. 3-4. Tiranë.